



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 75

Prishtinë, më 11.7.2016, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selviqe Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević

Munguan: Doruntinë Maluku, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Egzon Pacolli- praktikant; Granit Berisha- UP; dhe Dren Ajeti-GLPS.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Nga stafi mbështetës: Mirjeta Heta, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 14.6 dhe 16.6.2016;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit plotësues me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
5. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore në Projektligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje;
6. Njoftim lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me kërkesën e dorëzuar nga z. Florent Muçaj;

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 14.6 dhe 16.6.2016

Kryetarja konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 14.6 dhe 16.6.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, (5 për dhe 1 abstenim) vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i raportit plotësues me amendamente për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin plotësues me amendamente për Projektligjin për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara të Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, (4 për dhe 1 abstenim) vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore në Projektligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje

Kryetarja tha se komisionet kryesore e kanë shqyrtuar raportin me amendamente të Projektligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje, të cilët nuk kanë pasur vërejtje. Më tej, kryetarja tha se nuk kam qenë pjesë e grupit punues dhe as nuk kam marrë pjesë në mbledhje të Komisionit për Legjislacion, për shkak të bojkotit, mirëpo vërejtjet eventuale do t'i them në seancë plenare.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqes këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Të miratohet Projektligji nr. 05/L-087 për kundërvajtje, me amendamentet e propozuara.

6. Njoftim lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me kërkesën e dorëzuar nga z. Florent Muçaj

Kryetarja njoftoi anëtarët e Komisionit se nga Gjykata Kushtetuese ka ardhur Aktvendimi për papranueshmëri lidhur me kërkesën e dorëzuar nga z. Florent Muçaj dhe e refuzon masën e përkohshme, që e ka kërkuar i njëjti.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-109, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016

Kryetarja, në fjalën e saj, tha se në seancë plenare jam munduar të kem një fjalim sa i përket kërkesave buxhetore të institucioneve që janë në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion. Sot është afati i fundit që deputetët dhe komisionet përkatëse mund t'i dërgojnë amendamentet për Projektligjin për buxhet. Znj. Haxhiu propozoi që kërkesat të cilat i kanë bërë institucionet që janë në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion, t'i procedohen Komisionit për Buxhet, edhe pse ne i kemi dërguar disa kërkesa më herët në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ministria e Financave ka njoftuar me shkrim se rekomandimi i Komisionit tonë lidhur me kërkesat për buxhet, nuk kanë mundur të përfshihen, sepse projektligji është dërguar në Sekretariatën Koordinues të Qeverisë. Tani i mbetet Komisionit për Buxhet dhe Financa të shqyrtojë rekomandimin tonë dhe të mbështesë ndonjë nga kërkesat buxhetore të institucioneve që janë në fushëveprim të Komisionit.

Armend Zemaj, në fjalën e tij, tha se ne e kemi nxjerrë një rekomandim për t'iu dhënë përkrahje atyre institucioneve, që kemi menduar se kanë më shumë nevojë për mbështetje financiare. Z. Zemaj kërkoi që rekomandimi i njëjtë, që i është dërguar Ministrisë së Financave, t'i dërgohet edhe Komisionit për Buxhet, për t'i mbështetur kërkesat buxhetore shtesë të këtyre institucioneve.

Kryetarja sqaroi, duke thënë se rekomandimi i njëjtë i është dërguar Ministrisë së Financave, njëkohësisht, edhe Komisionit për Buxhet dhe Financa, një ditë pasi e kemi marrë vendimin në Komision.

Selviqe Halimi, në fjalën e saj, tha se në qoftë se ne do të dërgonim amendament, do të duhej të tregonim organizatën buxhetore, se ku i merr të hollat dhe vlerën e saj dhe të bëjmë këtë specifikim, ne ndoshta mund ta kemi pak vështirë. Jam njoftuar që rekomandimi i Komisionit për Legjislacion i ka shkuar Komisionit për Buxhet dhe Financa, së bashku me të gjitha kërkesat tjera buxhetore. Disa kërkesa i ka marrë vetë Qeveria dhe i ka futur në rishikim të buxhetit. Ne kërkojmë që të paktën për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, të ndahet buxhet shtesë.

Agim Aliu, në fjalën e tij, tha se kërkesat që janë bërë nga Komisioni ynë, kemi pasur parasysh dhe faktin se është rishikim i buxhetit dhe është vështirë të gjinden mjete përmes shkresës që ne kemi dërguar. Prandaj, kërkoj të bëhet komunikimi i mirë, qoftë formal apo joformal, që të shohim si po shkon puna lidhur me rekomandimin për kërkesat buxhetore të institucioneve që janë në fushëveprimin e Komisionit, që ka dërguar Komisioni ynë në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni u pajtua që në Komisionin për Buxhet dhe Financa, për të arsyetuar rekomandimin e Komisionit, dt. 28.6.2016, për kërkesat buxhetore të institucioneve që janë në fushëveprim të Komisionit, të marrin pjesë:

1. Agim Aliu dhe
2. Armend Zemaj.

8. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 09:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

